



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 377, Datë 26.12.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË MBI
PËRCAKTIMIN TË DETYRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 8 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”, nenit 19, gërma “b” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe neneve 19 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2527 prot., datë 26.12.2023 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Metodologjia ka për qëllim të përcaktojë përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.
- Akti i hartuar është i përberë nga tre pjesë (Dispozita të Përgjithshme, Metodologjia për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe Dispozita të fundit) dhe ka në tërësi 14 nene.
- Në pjesën e tretë të Metodologjisë, përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) dhe ERE-s (neni 4), furnizuesve të energjisë elektrike (neni 5), parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi (neni 6), llogaritja e detyrimit për energjinë e rinovueshme (neni 7), faturimi dhe pagesa e detyrimit për energjinë e rinovueshme dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi (neni 8), rregullat e detyrimit të energjisë së rinovueshme (neni 9) si dhe kufiri maksimal për instrumentet afatshkurtër për likuiditet nga furnizuesit dhe nga OER (neni 10).
- Në dispozitat kalimtare, Metodologjia ka përcaktuar rishikimin e jashtëzakonshëm kur ka një devijim të tepruar ndërmjet vlerave të parashikuara dhe të realizuara për qëllimin e llogaritjes së detyrimit për energjinë e rinovueshme sipas neneve 7 dhe 9, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve kontraktuale, rishikimin dhe ndryshimin e Metodologjisë dhe hyrjen në fuqi të saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletore Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI